



K.DH.SH.II.nr.1036/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetar, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Sopaj” Sh.P.K me seli në Prizren, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.986/18 të datës 12.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë, 11.01.2024, merr këtë;

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditësit “Sopaj” Sh.P.K me seli në Prizren, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.986/18 i datës 12.01.2021 dhe gjykohet si vijon:
- II. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Sopaj” Sh.P.K, ANULOHET vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës – Departamentit të Ankesave Nr.69/2010 datë 30.04.2010.
- III. Lirohet tërësisht nga ngarkesa dhe pagesa për të gjitha llojet e ttimit shtesë, për Tatimin në fitim për vitin 2003 dhe 2004, Tatimin mbi Korporata për vitin 2006 dhe TVSH për vitin 2006 i rezultuar nga rritja e qarkullimit shtesë sipas Njoftim Rivlerësimeve të Administratës Tatimore – Regjioni Prizren.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal në pikën I të dispozitivit ka vendosur: I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit “Sopaj” Sh.P.K, me seli në Prizren, si e pa bazuar. Në pikën II. Mbetët në fuqi vendimi nr.69/2010 i datës 30.04.2010 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe Aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aprovohet në tërësi si e bazuar padia – kërkesëpadia e paditësit “Sopaj” Sh.P.K me seli në Prizren, kurse Vendimi i Departamentit për Ankesa të ATK-së Nr.69/2010 i datës 30.04.2010 për lënjen në fuqi të Njoftimeve kontestuee të Administratës Tatimore të Kosovës – Regjioni i Prizrenit për Rivlerësim të Tatimit në Fitim për vitin 2003 dhe 2004, Tatimit mbi Korporata për vitin 2006 dhe Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për vitin 2006 të datës 04.02.2010, Të Prishet dhe Ndryshohet në dobi të paditësit andaj paditësi “Sopaj” Sh.P.K me seli në Prizren lirohet nga detyrimi për të paguar tatime shtesë në shumë të përgjithshme prej 8,538.94 euro bashkë me ndëshkime dhe interes, ose që lënda të kthehet për rishqyrtim dhe rivendosje Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është **e bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin nr.69/2010 i datës 30.04.2010, Ankesën e tatimpaguesit “Sopaj” me NRB:701483537/600018304 pronar M.S. nga Rahoveci, Rr. “Xhemajl Kada” nr. 502, refuzohet si e pa bazë kundër vendimit mbi Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të Administratës Tatimore – Regjioni i Prizrenit. Procedura e ankesës nuk

ndërprenë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj Tatimi, sipas Ligjit nr.2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 12.01.2021, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, të mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin e të paditurës. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka konfirmuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e kontrollit, me të cilat paditësi është ngarkuar me detyrime tatimore shtesë. Bazuar në provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të ndryshonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja që ka konstatuar e paditura në procedurën administrative të ankesave dhe atë të kontrollit, për arsye se paditësi as para gjykatës nuk ka mund të kundërshtoj provat e gjetura nga kontrolli. Gjykata konsideron se e paditura me të drejt ka konfirmuar vlerësimin zyrtar të kontrollit tatimor i cili vlerësim është bërë konform dispozitave të Ligjit nr.2004/48 dhe Rregulloreve 2001/17 për TVSH, Rregullorja 202/3, dhe R2004/51. Në vlerësim të tillë të kontrollit me rastin e verifikimit të çmimeve në vlerën e hapur të tregut, gjykata e konsideron si veprim të drejt për të vërtetuar marzhën reale nga shitja e produkteve të njëjta në treg. Nga analiza e çmimeve të artikujve me pjesëmarrje më të madhe të sasive në shitje nga kontrolli është vërejt se marzha është më e madhe, dhe ky ndryshim i çmimeve është vërejt nga analiza e produktit gips, pllata, bimplastV30K ku sasi e pjesëmarrjes është 33490kg me marzhën prej 10% që dëshmojnë kartelat e paditësit për çmime blerëse dhe shitëse, dhe artikulli stuck gips, me sasinë e pjesëmarrjes prej 22290kg. Nga intervista e datës 10.05.2007, që ka pasur paditësi gjatë vizitës së kontrollit, vet paditësi ka pranuar se ka një marzhë prej 10%.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë, sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka vlerësuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në konkludime të gabueshme lidhur me gjendjen faktike, duke bërë interpretim të gabueshëm të fakteve të vërtetuara dhe duke mos i vlerësuar në tërësi faktet vendimtare, ashtu që e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykitimit thekson se nuk ka mundur të marrë për bazë pretendimet e paditësit se është aplikuar metodologjia e gabuar për vërtetimin e marzhës tregtare. Gjykata konstatoi se gjendja e analizës financiare nga kontrolli është bërë nga dokumentacioni që ka paraqit paditësi para kontrollit blerjet, shitjet, kuponët për periudhën tatimore dhe çmimet e produkteve në vlerën e hapur të tregut. Paditësi nuk ka ofruar para kontrollit një gjendje tjetër faktike të çmimeve të shitjes së këtyre produkteve të shitjes në treg. Gjykata konsideron se e paditura ATK-ja ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike pasi që paditësi nuk ka ofruar prova materiale relevante për të dëshmuar të kundërtën e vlerësimit tatimor bazuar në dispozitat e legjislationit tatimor në fuqi. E paditura ka vërtetuar drejt faktet esenciale dhe ka nxjerr konkluzion të drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, duke aplikuar drejt edhe dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështet në fakte jo relevante dhe me interpretim të gabuar të dispozitave ligjore.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale erdhën në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*.

Kolegji vlerëson se lidhur me kontestin e qarkullimit shtesë nga i cili ka rezultuar tatimi shtesë për periudhën kontrolluese, duke rritur marzhën në totalin e shitjeve (KMSH), ky vlerësim

nga Departamenti i Ankesave nga ri kontrolli për tatimin shtesë është i pa bazë ligjore për shkak se është bërë në mënyrë subjektive rritja e marzhës sipas metodologjisë së gabuar, duke përzgjedhur vetëm disa artikuj që përmbajnë marzhën më të lartë dhe duke eliminuar pa bazë artikujt tjerë të shitur, e që automatikisht prodhon rezultat të marzhës me koeficient të gabuar në krahasim me marzhën objektive, në bazë të formulës nga gjendja e barazuar materialo-financiare të raportit: blerje – shitje – stok ($M_{zh} = T_{sh}/S' + B - S$ ”).

Nga Kolegji është konstatuar se nga ana e ri kontrollit në këtë rast nuk është konstatuar për parregullsi që do të bien ndeshë me dispozitat ligjore, pasi që nuk është faktuar dokumentuar për mungesë materiale-financiare të stokut sipas llojit, sasisë dhe çmimit apo të hyrjes së mallit pa mbulesë, si dhe për nënvlerësim të çmimeve përmes faturave të shitjes apo kuponëve të shitjes, atëherë nga këtu nënkuptohet se nuk mund të ketë kurrfarë qarkullimi shtesë përveç atij të supozuar si rezultat i ngritjes së marzhës sipas koeficienteve joreal nga metodologjia e gabuar të kalkulimit të marzhës mesatare nga raporti blerje-shitje të artikujve të përzgjedhura nga kontrolli që përmbajnë në veti marzhën më të lartë duke eliminuar në analizë artikujt e tjerë të shitur nga blerjet gjatë vitit dhe stokut të bartur nga viti paraprak dhe për këtë arsye vlerësimet e kontrollit për tatim shtesë, janë pa mbështetje ligjore dhe të pa bazuara. Tutje, sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 2004/48 dhe të Ligjit Nr. 03/L-071, nuk janë dhënë argumente të reja nga ri kontrolli për pasaktësi në deklaratat tatimore të ankuesit, e që në këtë ri kontroll ka dështuar në vlerësimin e qarkullimit shtesë për vitin 2006, duke mos e përdorur mesataren aritmetikore të ponderuar për të nxjerr çmimin mesatar të shitjes, andaj nuk mund të pranohet një vlerësim për tatim shtesë nëse paraprakisht nuk vërtetohet gjendja faktike për parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore. Në rastin konkret është aplikuar metodologji e gabuar në gjetjen e marzhës mesatare vjetore, që ka rezultuar me rritje fiktive të shitjeve nga i cili duhet të rezultojë tatimi shtesë në kuptimin se sa do të ishte qarkullimi, sikurse tërë malli i shitur të ishte realizuar me marzhën e përzgjedhur nga kontrolli sipas koeficientit joreal. Andaj edhe nga ana e Departamentit të Ankesave dhe nga raporti i ri kontrollit nuk është dhënë asnjë arsyetim i bazës ligjore mbi aplikimin e metodologjisë në përcaktimin e marzhës mesatare, kur me rastin konkret nuk është dëshmuar me asnjë provë nënvlerësim të çmimeve përmes ndonjë fature apo kupon të shitjes që do të faktonte se ankuesi u ka shitur mallin lëndor blerësve të fundit me çmim më të lartë se sa çmimet sipas faturave dhe kuponëve të shitjes që janë regjistruar në libër të shitjes.

Bazuar në të lartcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale,

vlërëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia si e tillë të aprovohet.

Nga të cekurat konform Nenit 195.1 pika e) dhe 201 b) të LPK-së u vendos si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1036/22, me datë 11.01.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**